



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 709/ prot.

Elbasan, me 20.03.2025

VENDIM

Nr. 45 datë 20.03.2025

Mbi

miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i shkencave në "Drejtësi" për vitin akademik 2025-2026

Bazuar në Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, neni 25, pika 7; neni 37, pikat 1 dhe 2, neni 38, pika 1, dhe pika 3, në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar, pika 2.7, germa a,b,c, në Statutin e UE-së "A. Xhuvani" neni 9, germa h, si dhe në Vendimin nr. 41, datë, 17.03.2025 të Senati Akademik të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", "*Mbi miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë për vitin akademik 2024-2025*", Bordi i Administrimit,

V E N D O S I :

1. Të miratojnë kuotat e pranimit në Universitetin e Elbasanit "A. Xhuvani" për vitin akademik 2025-2026, në programet e studimit me karakter profesional, ciklit të parë të studimeve Bachelor dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, me kohë të plotë (Tabela 1 bashkëlidhur), **2310 kuota** të ndarë si më poshtë vijon:
 - a) Kuotat e pranimit për kandidatë studentë brenda vendit: **2010 kuota**.
 - b) Kuota e pranimit për kandidatë studentë nga trojet: **36 kuota**.
 - c) Kuotat e pranimit për kandidatë studentë shtetas të huaj: **3 kuota**.
 - d) Kuota e pranimit për kandidatët studentë nga kategoritë e veçanta (me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët studentë romë dhe egjiptianë: **28 kuota**.
 - e) Kuotat e pranimeve për kandidatët studentë që aplikojnë për transferim studimesh: **83 kuota**.

- f) Kuotat e pranimit për kandidatët studentë që aplikojnë për një program të dytë studimi: **150 kuota.**
2. Kuotat e parealizuara të pikave 1/b; 1/c; 1/d; 1/e; 1/f do të shpërndahen nga Rektorati sipas kërkesave të njësive kryesore të UE-së.
 3. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit , Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
 4. Ngarkohet Administratori i Universitetit “Aleksandër Xhuvani” për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT

Dr. Ardian Durmishi

